



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Mars 2023

Nr: 162

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË ROSKOVEC, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 10 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Roskovec

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Roskovec, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 11.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Roskovec.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 10 Mars 2023

Nr: 162
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Roskovec, për raportimin e veprimtarive publike”

“Bashkia Roskovec ka postuar në faqen Facebook të institucionit, zhvillimin e inspektimit të shkollës 9-vjeçare “5-Dëshmorët” Suk 1. Postimi mban datën 24 Janar 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 24 Janar 2023 ose përpara kësaj date. Ndërkohë nga konsultimi i ndërfaqes së raportimeve të KQZ, Bashkia Roskovec ka raportuar në datën 20 Janar 2023, për zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim i punimeve ne objektin “Shkolla 9- vjeçare 5 Dëshmoret”, Suk 1, Roskovec”, të cilin planifikonte ta zhvillonte në datën 27 Janar 2023”.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë **16.2.2023**, bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e parë të marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë **20.2.2023**, bashkia Roskovec bën me dije se: *“Për këtë aktivitet, Inspektim i punimeve në shkollën 9 vjeçare “5 Dëshmorët” Suk 1 është parashikur të zhvillohet në datë 27.1.2023 dhe për këtë është bërë raportimi në datën 20.1.2023 (pra 7 ditë përpara zhvillimit të saj). Për shkak të një problematike në projekt, **mospërputhje e projektit me sipërfaqen faktike**, të dalë gjatë zbatimit të tij, si edhe sipas kërkesës emergjente të mbikqyrësit të punimeve u pa e nevojshme inspektimi në vend i objektit nga përgjegjesi i sektorit të zbatueshmërisë së investimeve dhe kryetarja e bashkisë. Për këtë shkak është zhvilluar aktiviteti përpara datës së raportuar (pas 4 ditëve nga raportimi). Konkretisht ky aktivitet u zhvillua ditën e martë, datë 24.1.2023, në orën 10:00. Ky aktivitet ka qenë pa praninë e mediave. Pjesëmarrës në inspektim kanë qenë kryetarja e bashkisë zj. Majlinda Bufi, përgjegjesi i sektorit të zbatueshmërisë së investimeve z. Arben Dukaj, dhe mbikqyrësi i punimeve dhe punonjësit e firmës zbatuese.”*

Për sa më sipër, pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, rezultoi se organi publik, ka kryer raportimin, dhe për shkaqe emergjente ka pasur ndryshim të datës së zhvillimit të aktivitetit.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i tërheq vëmendjen personit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, për njoftimin e ndryshimeve pranë ndërfaqes në raste emergjente.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Roskovec.
2. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Roskovec për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI